

VENDIM
Nr. 747, datë 5.9.2013

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 638, DATË 31.7.2013 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË
DREJTAT E NJERIUT, DATË 31.7.2012, PËR ANKIMET NR. 604/07, NR. 43628/07, NR.
46684/07 DHE NR. 34770/09 “MANUSHAQE PUTO DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 5 e vendimit nr. 638, datë 31.7.2013 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“5. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha